



MANUAL METODOLOGJIK

**LLogaritë Rajonale
në Shqipëri**

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE: HYRJE, METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE.....	3
1.1 Organizimi dhe vlerësimi i treguesve rajonalë	4
1.2 Një vështim i përgjithshëm i metodologjisë.....	4
1.3 Burimet e të dhënave në llogaritjen e VSHB-së Rajonale	5
2. KALENDARI I PUBLIKIMIT, POLITIKAT RISHIKUESE, AKSESI PËR PËRDORUESIT	5
2.1 Kalendar i Publikimit për treguesit rajonalë.....	5
2.2 Politikat Revizionuese.....	5
2.3 Krahasueshmëria në kohë	6
2.4 Aksesit për publikun	6
3. METODOLOGJIA E PËRDORUR NË LLOGARITJEN E VSHB-SË RAJONALE	8
3.1. PARIME TË APLIKUARA SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË.....	8
3.1.1. Burimet e të dhënave.....	9
3.1.2. Kalibrimi dhe ekstrapolimi	12
3.1.3. Trajtimi i aktiviteteve ndihmëse	12
3.1.4. Gjithpërfshija (exhaustiveness)	13
3.1.5. Llogaritja e FISIM-it si dhe shpërndarja rajonale dhe sipas degëve të ekonomisë të FISIM	13
3.1.6. Kalimi nga VSHB në PBB.....	14
3.2. METODA SPECIFIKE NË LLOGARITJEN E VSHB-SË RAJONALE SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË.....	14
3.2.1. NVE A, B – Bujqësia, gjuetia, silvikultura dhe peshkimi	14
3.2.2. NVE C – Industria nxjerrëse	15
3.2.3. NVE D – Industria Përpunuese	16
3.2.4. NVE E – Prodhimi dhe Shpërndarja e Energjisë Elektrike, e Gazit e Avullit dhe e Ujit.	17
3.2.5. NVE F – Ndërtimi	18
3.2.6. NVE G; H – Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, artikujve personalë dhe shtëpiakë, hotelet dhe restorantet.	19
3.2.7. NVE I – Transportet, Magazinimi dhe Komunikacioni.....	20
3.2.8. NVE J – Aktiviteti Financiar.....	21
3.2.9. NVE K – Pasuritë e Patundëshme, Qiradhënia, Aktivitete të tjera profesionale	22
3.2.10. NVE L, M ,N – Administrata Publike dhe Mbrojtja Kombëtare; Arsimi; Shëndetsia dhe veprimtari të tjera sociale	23
3.2.11. NVE O, P – Aktivitete të tjera të Shërbimit Kolektiv, Social dhe Individual	24
3.3. VSHB RAJONALE ME ÇMIMET E VITIT TË KALUAR	25
4. Vetëvlerësimi i Llogarive Rajonale dhe plane të ardhshme	25
4.1 Vlerësimi i metodologjisë së Llogarive rajonale	25
4.2 Përmirësime të mëtejshme	26
ANEKS.....	27
ANEKS I. Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011	27
ANEKS II. Tabela e Llogaritjes së VSHB-së Rajonale	29
ANEKS III. Struktura e degëve të ekonomisë në % viti 2012	30
ANEKS IV. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike	31
ANEKS V. Referenca.....	32

1. PËRMBLEDHJE: HYRJE, METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Në 28 Prill 2011 EUROSTAT konfirmoi propozimin e Institutit të Statistikave, të aprovuar nga Këshilli i Ministrave¹, për ndarjen e Shqipërisë në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, përbërja e të cilave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Struktura rajonale e Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Kodi	Rajoni Statistikor Niveli 1	Rajoni Statistikor Niveli 2	Rajoni Statistikor Niveli 3
Republika e Shqipërisë			
AL		Veri	
AL01			
AL011			Dibër
AL012			Durrës
AL013			Kukës
AL014			Lezhë
AL015			Shkodër
AL02		Qendër	
AL021			Elbasan
AL022			Tiranë
AL03		Jug	
AL031			Berat
AL032			Fier
AL033			Gjirokastër
AL034			Korçë
AL035			Vlorë

Ndarja e territorit të Republikës së Shqipërisë është në koherencë me rregulloren e Komisionit Europian (KE-së) nr 1059/2003 mbi Parlamentin Europian si dhe me Këshillin e tij më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të njësive territoriale për statistikat (NUTS).

Numri i popullsisë për çdo njësi jo-administrative në nivel NUTS 2 është i harmonizuar me intervalin e vendosur nga Komisioni Europian nga 800 mijë banorë në një maksimum prej 3 milion banorësh.

Rajonet statistikore niveli 3 janë njësi administrative (Qarqet). Numri mesatar i popullsisë për nivelin 3 është 241.707 banorë për vitin 2012 brenda intervalit 150 në 800 mijë banorë.

NUTS	Numri minimal i banorëve	Numri maksimal i banorëve
NUTS 1	3.000.000	7.000.000
NUTS 2	800.000	3.000.000
NUTS 3	150.000	800.000

¹ Vendimi i KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian"

1.1 Organizimi dhe vlerësimi i treguesve rajonalë

Llogaritë Rajonale vlerësohen nga Sektori i Administratës Publike dhe Llogarive Rajonale në Drejtorinë e Llogarive Kombëtare. Për nxjerrjen e treguesve bashkëpunohet me Sektorin e Llogarive Kombëtare Vjetore. Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) dhe Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) rajonal u publikuan për herë të parë në vitin 2011 për vitin 2009. Në vitin 2014 të dhënat janë publikuar për periudhën 2008-2012. Llogaritë Rajonale publikohen çdo vit rreth 19 muaj mbas periudhës së referencës, duke ndjekur publikimin vjetor të Llogarive Kombëtare në fund të muajit Maj me spostim prej t-2 muajsh. Burimi kryesor i të dhënave janë Llogaritë Kombëtare Vjetore. Të dhënat janë vlerësuar në nivel rrethi (36) të cilat më pas janë agreguar në rajon statistikor nivel 3 (12 qarqe) dhe rajone statistikore nivel 2 (3 rajone). Të dhënat publikohen në nivel statistikor 3 dhe 2.

1.2 Një vështim i përgjithshëm i metodologjisë

Ky manual jep një përshkrim të vlerësimit të Llogarive Rajonale në Shqipëri. Qëllimi është të japi një përshkrim të të dhënave të përdorura dhe metodologjisë së përdorur në alokimin e të dhënave vjetore. Manuali fokusohet në përpilimin e Vlerës së Shtuar Bruto si dhe në Produktin e Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore. Vlerësimet janë në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare (ESA).

Në Llogaritë Rajonale si dhe në vlerësimin e treguesve të saj është përdorur metoda e prodhimit. Të njëjtat burime të dhënash si në Llogaritë Vjetore janë përdorur për matjen e prodhimit dhe konsumit ndërmjetës dhe në nivel rajonesh statistikore.

Metodat e përdorura janë një kombinim i metodës Poshtë –Lart, metodës Mikse (Metoda Pseudo-Poshtë-Lart) dhe metodës Lart-Poshtë në një linjë me Manualin e ESA Kapitulli 13:

- Metoda Poshtë-Lart bazohet në principin se i gjithë informacioni mbledhet nga KAU lokale dhe më pas agregohet në nivel total ekonomie.
- Metoda Lart-Poshtë është metoda inverse me atë më sipër. Vlera e VSHB shpërndahet tek një rajon dhe në degë të ekonomisë dhe jo tek njësitë lokale. Në këtë rast indikator shpërndahet me anë të peshave rajonale duke përdorur një tregues sa më të afërt me vlerën e shtuar.
- Metoda Pseudo-Poshtë-Lart është një ndërthurje e metodave të mësipërme. Kjo metodë konsiston në vendosjen e peshave rajonale tek ndërmarrjet kur të dhënat për njësitë lokale mungojnë. Peshat mund të jenë treguesit e kompensimit të punonjësve, numri i punonjësve etj, sipas njërive lokale dhe rajoneve statistikore. Mjaft ndërmarrje kanë njësi lokale vetëm në një rajon dhe metoda e përdorur në këtë rast është metoda Poshtë – Lart.

Në vlerësimin e Llogarive Rajonale, Vlera e Shtuar Bruto llogaritet me çmime bazë. Në llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore, VSHB kalohet me çmimet e tregut. Kjo arrihet me mbledhjen e taksave dhe zbritjen e subvencioneve sipas produkteve. Taksat dhe subvencionet janë shpërndarë sipas strukturës së VSHB-së. Në llogaritjen e indikatorëve rajonalë me çmime të vitit të mëparshëm, janë përdorur deflatorët vjetorë sipas degëve të ekonomisë. Për momentin, nuk ka të dhëna të disponueshme mbi çmimet në nivel rajonesh statistikore.

1.3 Burimet e të dhënave në llogaritjen e VSHB-së Rajonale

Vlerësimi i Llogarive Rajonale bazohet në burimet e disponueshme të të dhënave të Llogarive Kombëtare Vjetore.

Burimet kryesore të të dhënave përfshijnë: burime statistikore dhe burime administrative. Ndër burimet statistikore përmendim të dhënat nga Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN), Anketat e Bujqësisë e të Peshkimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Mjedisit, Anketa mbi Forcat e Punës (AFP), Statistikat e Çmimeve, Regjistri i Ndërmarrjeve, etj. Ndër burimet administrative mund të përmendim p.sh. Formulari i deklarimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), pasqyrat financiare vjetore, raportet vjetore të Sistemit Bankar, raportet vjetore të Sistemit të Sigurimeve, të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Shtetit, etj. Në nivel kombëtar dhe në nivel rajonesh statistikore të njëjtat klasifikime janë përdorur për degët e ekonomisë.

2. KALENDARI I PUBLIKIMIT, POLITIKAT RISHIKUESE, AKSESI PËR PËRDORUESIT

2.1 Kalendar i Publikimit për treguesit rajonalë

Llogaritë Rajonale bazohen në të njëjtat principe dhe përkufizime si dhe Llogaritë Kombëtare Vjetore të cilat janë në një linjë me metodologjinë e ESA. Të njëjtat burime të dhënash janë përdorur si në llogaritë rajonale ashtu edhe në ato kombëtare sipas manualit “Metodat e Llogarive Rajonale – Vlera e Shtuar Bruto dhe Formimi Bruto i Kapitalit Fiks sipas aktiviteteve” i publikuar nga EUROSTAT .

Llogaritë Rajonale publikohen çdo vit , T+19 muaj mbas muajit të referencës. Publikimi i Llogarive Rajonale pason publikimin e Llogarive Kombëtare Vjetore. Kalendar i botimit për Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe ato Rajonale gjenden në websitin e INSTAT:

<http://www.instat.gov.al/al/publications/kalendar-i-publikimeve.aspx>

Të dhënat mbi Llogaritë Rajonale për vitin 2012 janë publikuar në Korrik të vitit 2014. Të dhënat janë publikuar sipas rajoneve statistikore niveli 2/3.

2.2 Politikat Revizionuese

Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe ato rajonale vlerësohen nga një sërë burimesh të dhënash (të dhëna administrative dhe statistikore). INSTAT për vitet 2008-2012 me çmime korente dhe konstante ka rishikuar të dhënat vjetore të vlerësimit e PBB-së nga përfshirja e burimeve të reja të të dhënave, përmirësimin e metodave statistikore duke implementuar kërkesat e metodologjive SNA 2008 dhe ESA 2010.

Këto ndryshime janë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji.. Tabela më poshtë tregon ndryshimet në përqindje në strukturën rajonale të PBB-së përpara dhe mbas ndryshimeve metodologjike.

Tabela 1: Ndryshimi në Strukturën Rajonale të PBB-së në %

Niveli Statistikor 3(Qark)	2011		
	PBB Rajonale, AL = 100		Diferencë në pik %
	Metoda e mëparshme	Metoda aktuale	
Dibra	3,2	2,9	-0,30
Durrësi	9,4	10,0	0,60
Kukësi	2,3	2,2	-0,10
Lezha	3,8	3,2	-0,60
Shkodra	6,3	5,7	-0,60
Elbasani	9,2	8,1	-1,10
Tirana	36,3	38,3	2,00
Berati	4,7	4,2	-0,50
Fieri	10,0	11,1	1,10
Gjirokastra	2,6	2,5	-0,10
Korçe	6,2	5,5	-0,70
Vlora	6,0	6,3	0,30

2.3 Krahasueshmëria në kohë

INSTAT publikon treguesit rajonalë në koherencë me zhvillimet dhe revizionimet e metodologjisë së Llogarive Kombëtare Vjetore. Rezultatet për çdo vit vlerësohen nga të dhëna të detajuara. Në rast se të dhënat mbi njësitë lokale mungojnë treguesit rajonalë vlerësohen duke marrë në konsideratë strukturën e vlerës së shtuar të një viti referues.

2.4 Aksesimi për publikun

Botimi i përvitshëm “Llogaritë Rajonale në Shqipëri” publikohet në web-sitin e INSTAT(www.instat.gov.al), në adresën e Publikimeve të Llogarive Kombëtare simë mëposhtë:

<http://www.instat.gov.al/al/themes/llogaritë-kombetare.aspx?tab=tabs-4>

Publikimi përmban një përshkrim plotësues të Llogarive Rajonale sipas degëve kryesore të ekonomisë duke përfshirë këto tabela:

- Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistikore Nivel 1, 2, 3
- Produkti i Brëndshëm Bruto në çmime korente
- Produkti i Brëndshëm Bruto në çmime të vitit të mëparshëm
- Produkti i Brëndshëm Bruto në Euro
- Produkti i Brëndshëm Bruto në PPS
- Rritja Reale e Produktit të Brëndshëm Bruto
- Popullsia mesatare në Shqipëri sipas Rajoneve Statistikore
- Produkti i Brëndshëm Bruto për frymë në Lekë
- Produkti i Brëndshëm Bruto për frymë, në Euro
- Produkti i Brëndshëm Bruto për frymë, në PPS sipas Rajoneve Statistikore Nivel 2
- Produkti i Brëndshëm Bruto për frymë, AL=100
- Produkti i Brëndshëm Bruto për frymë, EU28=100 sipas Rajoneve Statistikore Niv.2
- Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas rajoneve dhe degëve të ekonomisë
- VSHB për 3 rajonet statistikore niveli 2 VSHB për 12 rajonet statistikore niveli 3 (Qarqe)

Tabelat sipas rajoneve statistikore nivel 2, 3 përfshijnë një detajim sipas 6 degëve kryesore të ekonomisë:

A+B	Bujqësia, gjuetia dhe pyjet;Peshkimi
C+D+E	Industria
F	Ndërtimi
G+H+I	Tregëti, Hotele dhe Restorante; Transporti dhe Komunikacioni
J+K	Ndërmjetësimi Financiarë, pasuri të pa-tundshme
L to P	Shërbime të tjera

3. METODOLOGJIA E PËRDORUR NË LLOGARITJEN E VSHB-SË RAJONALE

Kjo pjesë e dokumentit paraqet një përshkrim të përgjithshëm për parimet metodologjike të llogaritjes së VSHB-së Rajonale, duke përshkruar burimet të cilat janë përdorur në llogaritjen e treguesve rajonalë si dhe metodat që janë aplikuar.

3.1. PARIME TË APLIKUARA SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË

Llogaritë Rajonale janë një specifikim rajonal i llogarive korresponduese të ekonomisë kombëtare. Llogaritë Rajonale sigurojnë një ndarje rajonale për agregatat më të rëndësishëm si Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve kryesore të ekonomisë, Produktit të Brendshëm Bruto etj.

Konceptet e Llogarive Kombëtare përdoren gjithashtu në Llogaritë Rajonale. Me vlerësimin e Llogarive Rajonale diferencat strukturore rajonale, zhvillimet e ekonomisë bëhen më të dukshme.

- **Koncepte dhe klasifikimet e përdorura**

Llogaritë Rajonale në Republikën e Shqipërisë bazohen në të njëjtat koncepte të ESA. Versioni kombëtar i Nomenklaturave të Veprimtarive Ekonomike të miratuara nga nomenklatura ESA95 dhe e përdorur gjërësisht në Llogaritë Kombëtare është paraqitur në Aneksin IV.

- **Parimi i Rezidencës**

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente , pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Parimi i rezidencës është veçanërisht i vështirë të aplikohet në disa degë të ekonomisë si energjia, transporti. Problemi kryesor është shpërndarja e VSHB-së sipas ndërmarrjeve që kanë aktivitet në më shumë se një rajon statistikor.

- **Klasifikimi i njësive statistikore në nivel rajonal të përdorura**

Disa nga çështjet specifike të Llogarive Rajonale lidhet me njësitë që ajo përdor. Në llogaritë rajonale vetëm njësia (ndërmarrja) dhe vendodhja e saj nuk mjafton , pra kërkohet njësi të tjera më të detajuara si psh KAU lokale. KAU lokale është një njësi institucionale e ndodhur në një rajon. Kjo është e identifikuar me rajonin ku është dhe qendra e interesit: rajoni ku KAU lokale ndodhet fizikisht.

- **Trajtimi i njësive multi-rajonale**

Mjaft njësi prodhuese kanë filiale në më shumë se një rajon dhe janë aktive në më shumë se një degë të ekonomisë. Dega ku kjo njësi do të klasifikohet duhet ti korrespondojë njësive lokale.

Trajtimi i njësive multi-rajonale dhe njësive që kanë disa aktivitete është i njëjtë me trajtimin që bëhet nga Llogaritë Kombëtare Vjetore. Analiza fillon me përcaktimin e aktivitetit kryesor që ushtron njësia, aktivitetin dytësor dhe aktivitetet ndihmëse.

Aktiviteti kryesor i një njësie lokale (local KAU) është aktiviteti ku vlera e shtuar është më e lartë se në aktivitete të tjera që ushtron njësia, një aktivitet dytësor është një aktivitet i cili ndërmeret si aktivitet shtesë së bashku me aktivitetin kryesor.

3.1.1. Burimet e të dhënave

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN)

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve mbulon të gjitha ndërmarrjet aktive në degët e ekonomisë si më poshtë :

- B (Peshkimi),
- C (Industria Nxjerrëse),
- D (Industria përpunuese),
- E (Energji elektrike, gaz, ujë dhe avull),
- F (Ndërtimi),
- I (Transporti, magazinimi dhe komunikacioni),
- G (Tregtia me shumice dhe pakice, Riparimi i automobilave, motoçikletave dhe paisjeve shtëpiake),
- H (Hotele dhe restorante),
- K (Pasuritë e patundshme, dhënia me qera, aktivitete profesionale),
- M (Arsimi Privat)
- N (Shëndetësia dhe veprimtari sociale private)
- O (Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual),

Bujqësia, pyjet, aktiviteti financiar, Administrata publike nuk janë përfshirë në mbulimin e saj.

Njësitë raportuese janë ndërmarrjet jo-financiare. Periodiciteti është vjetor dhe i referohen vitit kontabël. Të dhënat paraprake janë të disponueshme 11 muaj mbas fundit të vitit të referencës. Struktura e zgjedhjes konsiston në të gjitha ndërmarrjet aktive në Rregjistrin e Biznesit për vitin përkatës të klasifikuara sipas aktiviteteve ekonomike me të paktën një punonjës. Kampioni është i ndarë sipas aktiviteteve ekonomike.

Trajtimi i ndërmarrjeve që nuk kanë informacion si pasojë e mos raportimit bëhet me metoda direkte dhe indirekte si psh:

- analiza e serive kohore sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe degës së ekonomisë
- duke përdorur të dhëna shtesë nga bilancet (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);
- informacion i siguruar nga burime të tjera si psh. Rregjistri i Biznesit, skedari i TVSH,

Statistikat e punësimit

Anketa e Forcave të Punës (AFP) është e disponueshme që nga viti 2007. Kampioni i zgjedhjes në vitet 2007-2010 ka qënë 7.740 familje. Që nga viti 2011 AFP ka kaluar në nivel tremujor.

Të dhënat mbi punësimin janë të disponueshme në NVE rev.1.1. dy- shifrore sipas degëve të ekonomisë. Të dhënat rajonale mbi punësimin sigurohen në nivel qarku dhe sipas aktiviteteve ekonomike.

Të dhëna nga Llogaritë Kombëtare Vjetore

Të dhënat e Llogarive Rajonale bazohen në të dhënat e përdorura nga Llogaritë Kombëtare Vjetore mbi Vlerën e Shtuar sipas degëve kryesore të ekonomisë.

Regjistrimi i Ndërmarrjeve 2010

Rezultatet e Regjistrimit të Ndërmarrjeve jo-financiare dhe jo-bujqësore e vitit 2010 siguroi informacion shtesë për kompanitë multi-rajonale (të dhëna mbi pagat, numrin e punonjësve). Kjo database siguron informacion mbi njësitë lokale për ndërmarrjet dhe për tregues që mund të përdoren në alokimin e VSHB-së.

• Metodologjia

INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale si një kombinim i metodave për alokimin e njësive uni dhe multi rajonale. Metodat për herë të parë u implementuan në vitin 2014 për treguesit e vitit 2012, të cilat janë konsistente me rekomandimet e EUROSTAT. Adoptimi i këtyre metodave ka përmirësuar treguesit në tërësi.

Llogaritë Rajonale janë vlerësuar si një kombinim i metodës poshtë-lart për njësitë uni-rajonale, metodës pseudo-poshtë lart për njësitë multi rajonale, si dhe metodës lart-poshtë për degë specifike si dhe për ekonominë e pavrojtuar. Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) dhe bilancet e ndërmarrjeve janë burimi kryesor i llogaritjes së përdorura nga Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe ato Rajonale.

Për shpërndarjen e VSHB-së janë përdorur të dhëna mbi prodhimin dhe konsumin ndërmjetës në nivel ndërmarrje. Për kompanitë multi-rajonale janë përdorur kryesisht të dhënat nga Regjistrimi i Ndërmarrjeve mbi njësitë lokale (peshat janë përfutur sipas numrit të punonjësve sipas LKAU). Metoda pseudo – poshtë lart vlerëson indikatorët sipas njësive lokale për çdo ndërmarrje. Pra shpërndarja e agregatëve nuk bëhet vetëm në nivel dege, por si shumatore e çdo njësie institucionale – ndërmarrjeje. Numri i punonjësve dhe kompensimi i punonjësve janë përdorur si pesha në këtë rast.

Për njësitë e tjera që vijnë nga skedari i TVSH-së janë përdorur peshat duke marrë si bazë vlerat rajonale të marra nga struktura e njësive uni-rajonale sipas degëve të ekonomisë ku ato bëjnë pjesë.

Janë kryer vlerësimet për çdo KAU lokale, e cila është e agreguar në totalin e VSHB-së sipas rajoneve dhe sipas 26 degëve të ekonomisë duke ndjekur NEV Rev.1.1.

Informacioni i disponueshëm përfshin treguesit e prodhimit, konsumin ndërmjetës, vlerës së shtuar e detajuar kjo sipas njësive, aktivitetit ekonomik dhe rajonit statistikor.

Formulat e aplikuara

Vlerësimi bëhet më vete për ato ndërmarrje të cilat kanë njësi lokale në më shumë se një qark (Ndërmarrje Multi-Rajonale) dhe ato që operojnë në një qark të vetëm (Ndërmarrje Uni-Rajonale).

- a) Për ndërmarrjet uni-rajonale Vlera e Shtuar vlerësohet si:

$$V_i = (O_i - I_i)$$

- b) Për ndërmarrjet multi-rajonale Vlera e Shtuar vlerësohet si:

$$V_i = (O_i - I_i) \frac{E_{ij}}{\sum_j E_{ij}}$$

Ku V_i është Vlera e Shtuar për ndërmarrjen i .

O_i është Prodhimi për ndërmarrjen i .

I_i është Konsumi Ndërmjetës për ndërmarrjen i .

E_{ij} është shuma e punësimit sipas njësive lokale për ndërmarrjen i në qarkun j .

Punësimi bazohet në Regjistrimin e Ndërmarrjeve.

Për vitin 2012, rreth 20,1 përqind e VSHB u alokua me metodën Poshtë-Lart kurse rreth 27,6 përqind me metodën Pseudo-Poshtë-Lart;


Sipas metodës Lart –Poshtë, duke përdorur si pesha rajonale kompensimin e punonjësve, u përdor në rreth 19,9 përqind të alokimit të VSHB-së, e cila është e lidhur me shpërndarjen rajonale të ekonomisë së pavrojtuar në degë të veçanta.

Metoda Lart-poshtë duke përdorur indikatorë të tjerë përbënte 32,4 % ku peshën më të madhe ishte në degën e Bujqësisë, Peshkimit, degën e Aktivitetit financiar si dhe treguesit e rentës së imputuar. Për më shumë detaje rreth metodologjisë shiko seksionin 3.2- Metoda specifike në llogaritjen e VSHB- rajonale.

Tabela: Mbulimi i metodave të përdorura

Metodat e përdorura VSHB, 2012	Struktura në %
Poshtë-Lart	20,1
Pseudo- Poshtë-Lart	27,6
Lart-poshtë (kompensimi i punonjësve)	19,9
Lart-poshtë (Indikatorë të tjerë)	32,4
Total VSHB	100,0

Figura 1: Metodatat e përdorura për rialokimin eVSHB-së sipas degëve të ekonomisë A-O, viti 2012 në %



3.1.2. Kalibrimi dhe ekstrapolimi

Procesi i Kalibrimit dhe ekstrapolimit nuk përdoren kur të dhënat vjetore janë të disponueshme në llogaritjen e Vlerës së Shtuar Bruto Rajonale pasi të dhënat vjetore janë të disponueshme në kohën e publikimit të Llogarive Rajonale. Në rast se të dhënat nuk do të ishin të disponueshme do të aplikoheshin struktura e Vlerës së Shtuar Bruto të një viti të dhënë.

3.1.3. Trajtimi i aktiviteteve ndihmëse

Njësia bazë e përpilimit të llogarive rajonale është njësia lokale (Lokal KAU). Një njësi institucionale mund të përbëhet nga më shumë se një njësi lokale, e lokalizuar në më shumë se një rajon statistikor. Në momentin aktual nuk ka të dhëna sipas njësive lokale dhe degëve të ekonomisë për aktivitetet ndihmëse.

3.1.4. Gjithpërfshija (exhaustiveness)

Në nivel kombëtar

Për të pasur vlerësime të PBB sa mëgjithëpërfshirëse, janë përmirësuar metodat për llogaritjen e ekonomisë së pavrojtuar (Non Observed Economy - NOE). Vlerësimet janë të bazuara në metodën tabelare të Eurostat-it për gjithëpërfshirjen në Llogaritë Kombëtare si dhe në manualin e OECD. U bë identifikimi i të gjitha llojeve të NOE-ve nga N1-N7 për të cilat mund të kryheshin vlerësime të drejtpërdrejta, duke përdorur të dhënat e rishikuara të Anketës së Forcës së Punës, Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve dhe Anketës së Buxhetit të Familjeve. Metoda e Inputit të Punës është aplikuar për të vlerësuar tipet e NOE-ve, N1 dhe N6 të metodës tabelare të Eurostat-it, për të gjitha aktivitetet duke përjashtuar bujqësinë, sektorin financiar dhe administratën publike. Gjithashtu për të vlerësuar nënraportimin e të ardhurave (N6) u përdor metoda "Franz".

Në nivel rajonal

Pesha për alokimin e VSHB-së për këto aktivitete (NOE) është një produkt vektorial i pagës mesatare nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN) dhe numrit të punonjësve sipas vendit të punës nga Anketa e Forcave të Punës (AFP). Punësimi sipas vendit të punës bazohet në Parimin e Rezidencës për alokimin e VSHB-së në rajonet përkatëse.

Shpërndarja rajonale për shumicën e aktiviteteve për ekonominë e pavrojtuar ndiqet nga formula e mëposhtme:

Paga mesatare për punonjës e për degën e ekonomisë në secilin rajon (ASN)

x

Numri i punonjësve për secilën degë të ekonomisë dhe rajon (AFP).

Pagat mesatare për punonjës bazohen nga rezultatet vjetore të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) dhe numrit të të punësuarve në çdo aktivitet e rajon bazuar në Anketën e Forcave të Punës (AFP). Ky vlerësim jep një peshë rajonale në përputhje me kompensimin e punonjësve për çdo rajon dhe degë të ekonomisë. Këto pesha janë përdorur më pas për të gjeneruar Vlerën e Shtuar rajonale sipas aktivitetit në përputhje me vlerat kombëtare.

3.1.5. Llogaritja e FISIM-it si dhe shpërndarja rajonale dhe sipas degëve të ekonomisë të FISIM

Në nivel vjetor llogaritja e FISIM u bazuar në informacionin për kreditë dhe depozitat e korporatave të tjera depozituese dhe institucioneve të tjera financiare të ndara sipas sektorit, aktivitetit ekonomik dhe llojit të valutës. Shpërndarja e FISIM-it tek përdorues të ndryshëm u krye duke u bazuar tek ESA 2010. Shpërndarja e FISIM-it u bë sipas aktiviteteve ekonomike.

Vlera e Shtuar Bruto Rajonale për degë të ekonomisë llogaritet duke zbritur konsumin e ndërmjetëm nga prodhimi. Vlerat kombëtare të konsumit të ndërmjetëm përfshijnë FISIM. Vlerësimet e rajonale të konsumit të ndërmjetëm përfshijnë këtë tregues. Shpërndarja rajonale e FISIM ndjek shpërndarjen rajonale (për aktivitet) të konsumit të ndërmjetëm.

3.1.6. Kalimi nga VSHB në PBB

Sipas rekomandimeve të EUROSTAT taksat mbi produktet (D.21) dhe subvencionet (D.3) rajonalizohen me të njëjtën strukturë si struktura rajonale e VSHB-së me çmime bazë (alokim proporcional). Nuk ka të dhëna në dispozicion për ndarjen rajonale të taksave dhe subvencioneve sipas rajoneve.

3.2. METODA SPECIFIKE NË LLOGARITJEN E VSHB-SË RAJONALE SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË

Ky paragraf përshkruan metodat dhe burimet të cilat janë përdorur për shpërndarjen e VSHB-së sipas degëve ekonomike në Shqipëri. Vlera e Shtuar Bruto është llogaritur në nivelin A26 degë dhe sipas NVE rev1.1.

3.2.1. NVE A, B – Bujqësia, gjuetia, silvikultura dhe peshkimi

Përshkrimi i degës

Dega e bujqësisë, gjuetia, silvikultura dhe peshkimi mbulon shfrytëzimin e burimeve bimore dhe blegtorale. Sektori përfshin aktivitetet e kultivimit të bimëve, rritjes së pemëve, korrjen e bimëve dhe rritjen e kafshëve nga ferma apo mjedise natyrore.

NVE A perbëhet nga dy degë:

- 01 Bujqësia, gjuetia dhe aktivitete shërbimi të lidhura me to
- 02 Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve dhe shërbime të lidhura me to

Seksioni 01 Bujqësia, gjuetia dhe aktivitete shërbimi të lidhura me to mbulon kryesisht e prodhimin e produkteve bimore dhe prodhimin e produkteve blegtorale.

Seksioni 02 Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve dhe shërbime të lidhura me to mbulon prodhimin e lëndës drusore, si dhe nxjerrjen dhe grumbullimin e materialeve të pyjeve. Gjithashtu në këtë kategori përfshihet lenda drusore që i nënshtrohen përpunimit jo thelbësor kryesisht për përdorim industrial.

VSHB në degën e bujqësisë është shpërndarë me metodën Lart-Poshtë duke marrë në konsideratë indikatorin e prodhimit në rajone. Vlera e artikujve bujqësorë dhe blegtoralë sipas rajoneve statistikore janë përfshuar si prodhim i sasisë së produkteve me çmimet respektive. Këto pesha janë aplikuar në indikatorët e prodhimit dhe konsumit ndërmjetës .

Në vitin 2012, Vlera e Shtuar Bruto për Bujqësinë, Blegtorinë dhe Peshkimin përbën 21,8 % të totalit të ekonomisë në Shqipëri .

Tabela 2: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

Rajon Statistikor	A Bujqësia, gjuetia, silvikultura	B Peshkimi
Berat	8,00	-
Dibër	6,30	0,65
Durrës	7,50	13,98
Elbasan	12,35	0,79
Fier	20,03	4,41
Gjirokastrë	3,70	2,52
Korça	9,73	4,28
Kukës	3,54	0,85
Lezhë	5,20	14,43
Shkodër	8,33	6,53
Tiranë	8,29	0,21
Vlorë	7,03	51,35
Totali	100,00	100,00

3.2.2. NVE C – Industria nxjerrëse

Industria nxjerrëse përbëhet nga nxjerrja e mineraleve nga burimet natyrore (qymyrit dhe mineraleve), lëngjeve (naftës) dhe gazrave (gazi natyror). Nxjerrja mund përbëhet nga minera nentokësore , sipërfaqësore ose nëpërmjet puseve .

Në Llogaritë Rajonale dega e industrisë , aktiviteti ekonomik NVE C, është klasifikuar në 4 degë:

- CA Nxjerrja e Mineraleve Energjitike
 - 10 Nxjerrja e qymyrgurit dhe linjiteve, nxjerrja e torfës
 - 11 Aktivitete shërbimi për nxjerrjen e naftës dhe gazit, përveç studimeve gjeologjike
- CB Nxjerrja e Mineraleve Jo Energjitike
 - 13 Nxjerrja e mineraleve metalike
 - 14 Industri të tjera nxjerrëse

Të dhënat nga ASN si dhe nga bilancet vjetore janë një burim i rëndësishëm për vlerësimin e VSHB-së për degën e industrisë nxjerrëse në Llogaritë Kombëtare. Pjesa më e madhe e prodhimit të aktivitetit ekonomik NVE C përbëhet nga sektori institucionaljo-financiare.

Për shpërndarjen e treguesve për degën e industrisë janë përdorur metodat Poshtë-Lart dhe Pseudo-Poshtë-Lart (Për metodën Pseudo-Poshtë-Lart është përdorur si çelës numri i punonjësve).

Industria nxjerrëse përbën rreth 5.6 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Sipas rajoneve dega CA (industria nxjerrëse e prodhimit të energjisë) ishte në qarkun e Fierit me një vlerë prej 79.38 % të totalit të prodhuar në vend.

Tabela 3: Peshë e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	CA-Nxjerrja e Mineraleve Energjitike	CB-Nxjerrja e Mineraleve Jo Energjitike
Berat	2,58	0,83
Dibër	-	35,11
Durrës	1,34	5,71
Elbasan	-	9,77
Fier	79,38	0,49
Gjirokastrë	-	0,25
Korçë	-	2,59
Kukës	-	1,33
Lezhë	-	16,42
Shkodër	-	5,34
Tiranë	9,39	15,21
Vlorë	7,31	6,95
Totali	100,00	100,00

3.2.3. NVE D – Industria Përpunuese

Veprimtaria e Industrisë Përpunuese është transformimi mekanik, fizik ose kimik i materialeve, lëndëve apo komponentëve të tyre në krijimin e produkteve të reja. Transformimi i materialeve, lëndëve apo komponentëve të tyre përdorin si lëndë të parë produkte që rrjedhin nga Bujqësia, Pyjet, Peshkimi, Industria nxjerrëse dhe nga aktivitete të tjera të Industrive Përpunuese. Produktet finale mund të jenë të përfunduara për përdorim final, për konsum final, ose mund të shërbejnë si lëndë e parë për prodhimin e një produkti tjetër përfundimtar.

Pjesa më e madhe e VSHB-së për aktivitetin NVE D përbëhet nga sektori institucional jo-financiare. Në këto raste për shpërndarjen e VSHB-së janë përdorur metodat Poshtë-Lart dhe Pseudo-Poshtë-Lart (Për metodën Pseudo-Poshtë-Lart është përdorur si çelës numri i punonjësve).

Dega e Industrisë Përpunuese përbën 6.8% të totalit të VSHB-së për vitin 2012. Në tabelën më poshtë është paraqitur struktura për secilën Qark sipas 9 degëve kryesore të ekonomisë.

Tabela 4: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

Rajon Statistikor	Prodhimi i produkteve me bazë drithërat	Të tjera produkte ushqimore	Prodhimi i produkteve tekstile dhe lëkurës	Prodhimi i drurit, letrës, mobiljeve, publikimeve dhe printimeve	Prodhimi i koksit produkteve të rafinimit të naftës dhe karburantit	Prodhimi i kimikateve, produkteve kimik, prej gome dhe plastike	Prodhimi i produkteve të tjera i mineraleve jo-metalike	Prodhimi i metaleve dhe produkteve metalike të fabrikuar	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve
Berat	4,03	1,81	5,93	6,72	1,30	2,31	2,22	0,90	26,04
Dibër	0,35	0,09	0,25	1,24	-	0,83	-	5,37	-
Durrës	7,59	5,38	25,03	10,10	2,18	12,93	47,25	15,20	7,46
Elbasan	13,67	1,50	3,80	11,05	-	17,00	9,13	41,13	11,54
Fier	5,21	12,55	4,07	5,28	88,71	6,74	4,80	2,62	1,78
Gjirokastrë	1,71	3,42	0,86	2,03	-	0,38	0,60	0,05	-
Korçë	8,23	29,49	9,24	2,80	-	2,94	3,87	0,45	0,26
Kukës	0,29	0,09	0,01	0,87	-	0,16	0,01	0,20	-
Lezhë	0,93	5,06	1,38	1,31	-	0,16	4,15	1,79	0,09
Shkodër	1,87	1,43	8,98	3,99	0,39	3,61	2,30	1,35	3,18
Tiranë	53,79	36,37	38,25	52,43	4,95	51,22	21,56	29,48	34,61
Vlorë	2,33	2,81	2,20	2,18	2,47	1,72	4,11	1,46	15,04
Totali	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

3.2.4. NVE E – Prodhimi dhe Shpërndarja e Energjisë Elektrike, e Gazit e Avullit dhe e Ujit.

Kjo degë përfshin aktivitetet që prodhohen nga energjia elektrike, gazi natyror, furnizimi me avull dhe furnizimi me ujë nëpërmjet një infrastrukture të përhershme të linjave, rrjeteve elektrike dhe tubave.

Në Llogaritë Kombëtare aktiviteti NVE E është klasifikuar në dy degë:

- 40 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ujit.
- 41 Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit

Për alokimin e degës 40, Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, janë përdorur disa çelësa të veçantë. Ky çelës është i përbërë nga kombinim i prodhimit të energjisë elektrike sipas qarqeve - 50%- dhe pjesa tjetër nga të dhënat që vijnë nga Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) -50%.

Për degën 41 (Furnizimi me ujë) janë përdorur metodat Poshtë-Lart dhe Pseudo-Poshtë-Lart (Për metodën Pseudo-Poshtë-Lart është përdorur si çelës numri i punonjësve) për shpërndarjen e VSHB-së sipas rajoneve .

NVE E – Energjia elektrike, gazit dhe ujit përbën 2.01% të totalit të VSHB-së për vitin 2012. Pjesa më e madhe e prodhimit të energjisë e përbëjnë qarku i Shkodrës dhe qarku i Kukësit respektivisht me 17.7% dhe 7.9% të totalit të VSHB-së.

Tabela 5: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	E - 40 Energjia elektrike	E - 41 Furnizimi me uje
Berat	1,05	4,24
Dibër	6,90	1,49
Durrës	5,37	6,10
Elbasan	5,04	12,47
Fier	6,99	7,09
Gjirokastrë	0,83	1,27
Korçë	1,98	6,90
Kukës	7,92	0,16
Lezhë	1,83	3,92
Shkodër	17,74	4,95
Tiranë	38,82	47,30
Vlorë	5,53	4,11
Totali	100,00	100,00

3.2.5. NVE F – Ndërtimi

Pjesa kryesore e prodhimit që rezulton nga dega e ndërtimit u realizua nga sektorët institucionale jo-financiare. Metodatat e përdorura për rajonalizimin e VSHB-së është metoda Poshtë-Lart dhe Pseudo-Poshtë-Lart (Për metodën Pseudo-Poshtë-Lart është përdorur si çelës numri i punonjësve).

Vlera e Shtuar për degën e Ndërtimit ndaj totalit të VSHB-së përbën 12.2 % për vitin 2012. Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (Qark) varion nga 1.20 % në qarkun Gjirokastrë në 55.96% në qarkun Tiranë.

Tabela 6: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	F – Ndërtimi
Berat	3,49
Dibër	1,26
Durrës	6,43
Elbasan	5,32
Fier	5,76
Gjirokastrë	1,20
Korçë	4,54
Kukës	2,63
Lezhë	2,99
Shkodër	4,31
Tiranë	55,96
Vlorë	6,11
Totali	100,00

3.2.6. NVE G; H – Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, artikujve personalë dhe shtëpiakë, hotelet dhe restorantet.

Dega sipas NVE G pëfshin kryesisht aktivitetet e bizneseve që kryejnë blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve. Prandaj një tipar i rëndësishëm i këtij klasifikimi është përqindja e lartë e marzhit tregtar të prodhimit.

Për aktivitetin sipas NVE G janë ndarë në 3 degë të industrisë:

- 50 Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilëve dhe motoçikletave
- 51 Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar (përveç mjeteve të transportit automobilistik)
- 52 Tregtia me pakicë; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiakë

Në vitin 2012 vlera e shtuar për aktivitetin NVE G përbën 13,08 % të VSHB-së së totalit të ekonomisë. VSHB sipas rajoneve varion nga 0,89 % në qarkun Kukës dhe 55,13% në qarkun Tiranë.

NVE H – Hotele dhe restorantet

Aktiviteti H (Hotele dhe Restorante) përbëhet nga hotele dhe banesa me akomodim afatshkurtër, restorantet, baret, mençat dhe katering. Aktiviteti NVE H është përfaqësuar kryesisht nga një degë ekonomike:

- 55 Hotele dhe restorantet

Në vitin 2012 VSHB për aktivitetin NVE H përbënte 2,05% të VSHB-së së gjithë ekonomisë. Këto shërbime janë gjërësisht të shpërndara në gjithë vendin por përqëndrim më të lartë shikohen në qarkun Tiranë me 54.14 % dhe në qarkun Durrës me 9.84 %.

Metodat e përdorura për rajonalizimin e VSHB-së është metoda Poshtë-Lart dhe Pseudo-Poshtë-Lart (Për metodën Pseudo-Poshtë-Lart është përdorur si çelës numri i punonjësve).

Tabela 7: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	G-Tregëtia	H- Hotele dhe restorantet
Berat	2,45	2,87
Dibër	1,11	1,31
Durrës	11,66	9,84
Elbasan	8,37	8,98
Fier	6,83	4,70
Gjirokastrë	1,05	0,80
Korçë	3,34	2,83
Kukës	0,89	0,90
Lezhë	2,40	1,88
Shkodër	2,59	5,43
Tiranë	55,13	54,14
Vlorë	4,18	6,32
Totali	100,00	100,00

3.2.7. NVE I – Transportet, Magazinimi dhe Komunikacioni

Aktiviteti ekonomik NVE I përfshin aktivitet e shërbimeve të transportit për pasagjerë apo mallra, transportit hekurudhor, transportit rrugor, transportit ujor dhe ajror si dhe shërbime të tjera në ndihmë si терминаlet apo shërbimet e parkimeve të mbyllura, kargo, magazinime, etj. Gjithashtu në këtë aktivitet ekonomik përfshihen edhe shërbimet e telekomunikacionit, qeradhënies së mjeteve të transportit të paisura me shofer ose operator të specializuar dhe aktivitete të agjensive të udhëtimit.

Aktivitetet e NVE I janë të veçuara në pesë degë kryesore të cilat janë grupuar në 2 grupe kryesore:

1. Transportet

- 60 Transporti tokësor;
- 61 Transporti ujor
- 62 Transporti ajror
- 63 Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjensive të udhëtimit

2. Postat dhe komunikacionet

- 64 Postat dhe komunikacionet

Tabela 8: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	I-Transportet	I- Postat dhe komunikacionet
Berat	2,45	3,44
Dibër	0,44	2,22
Durrës	38,64	5,70
Elbasan	4,12	3,97
Fier	3,97	4,80
Gjirokastrë	1,91	3,00
Korçë	1,21	4,04
Kukës	1,07	1,84
Lezhë	3,94	2,46
Shkodër	2,96	3,86
Tiranë	33,05	59,22
Vlorë	6,24	5,46
Total	100,00	100,00

Aktiviteti ekonomik NVE I përbën 3,8 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Vlerësimet sipas qarqeve varionin nga 0,44% në qarkun Dibër dhe 38,64 % në qarkun Durrës.

3.2.8. NVE J – Aktiviteti Financiar

Aktiviteti ekonomik NVE J është i shpërndarë në të gjitha qarqet por një peshë të rëndësishme ka qarku Tiranë . Aktiviteti ekonomik NVE J mund të shpërndahen në tre degë kryesore:

- 65 Aktiviteti Financiar, përveç aktiviteteve siguruese si dhe fondeve të pensioneve – Në këtë degë bëjnë pjesë Banka e Shqipërisë dhe bankat e tjera të nivelit të dytë.
- 66 Aktivitete siguruese dhe të fondeve të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme- Kjo degë përfshin njësitë e angazhuara në rishpërndarjen e risqeve me ose pa element sigurie.
- 67 Aktivitete ndihmëse të aktiviteteve financiare dhe atyre siguruese- Në këtë degë përfshihen aktivitete të tjera në tregun financiar që kanë një natyrë tjetër nga ato të sipërpërmendura.

Shumica e kompanive që operojnë në këtë degë janë multi-rajonale (bankat, kompanite e sigurimit, etj). Për rajonalizimin e treguesve të VSHB-së janë përdorur metoda Lart-Poshtë duke përdorur strukturën e numrit të punonjësve nga kompanitë VIP, burim i informacioni nga DPT.

Tabela 9: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	J-Aktiviteti Financiar
Berat	2,19
Dibër	1,01
Durrës	5,88
Elbasan	3,38
Fier	5,14
Gjirokastrë	2,33
Korçë	4,19
Kukës	1,09
Lezhë	2,46
Shkodër	3,39
Tiranë	64,41
Vlorë	4,53
Totali	100,00

Aktiviteti ekonomik NVE J përbën 2,41 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Vlerësimet sipas qarqeve varionin nga 1,01% në qarkun Dibër dhe 64,41 % në qarkun Tiranë.

3.2.9. NVE K – Pasuritë e Patundshme, Qiradhënia, Aktivitete të tjera profesionale

Aktiviteti ekonomik NVE K përbëhet nga pesë grupe:

- 70 Aktivitete të pasurive të patundshme
- 71 Dhënia me qera e paisjeve pa operator dhe e artikujve personale dhe shtëpiake
- 72 Aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to
- 73 Kërkime - aplikime eksperimentale
- 74 Aktivitete të tjera profesionale

Pesha e VSHB-së për aktivitetin ekonomik NVE K në 2012 përbënte 4,6 % në totalin e ekonomisë. Kjo degë përfshin Aktivitete të pasurive të patundshme, dhënia me qera si dhe aktivitete të tjera profesionale dhe kanë një përqëndrim më të madh në qarkun Tiranë.

Metoda e kostos është përdorur për vlerësimin e treguesve të qerasë së imputuar.

Qeraja e imputuar është qeraja që konsiderohet të paguhet nga zotëruesit e banesave nëse supozohet se ata do të jetonin në një banesë me qera. Implementimi i duhur i Metodës së Kostos për vlerësimin e qerasë së imputuar kërkon një numër të madh burimesh të dhënash për secilin komponent që do të integrohet në llogaritjet përkatëse. Censusi i Popullsisë dhe Banesave, i kryer në Tetor 2011, siguroi një informacion më të detajuar përsa i përket vlerësimeve për qeranë e imputuar të zotëruesve të banesave duke qenë se grumbulloi të dhëna mbi stokun e banesave, vitin e ndërtimit, etj.

Llogaritjet janë bazuar në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 të shkallëzuara sipas dymbëdhjetë qarqeve (të ndara në zona urbane dhe rurale), vitit të ndërtimit dhe llojit të banesave (shtëpi individuale, shtëpi pjesërisht e veçuar, apartament, etj).

Për qëllimet e Llogarive Rajonale struktura e treguesve të vitit 2011 është marrë si bazë për rialokimin e Qerasë së Imputuar sipas rajoneve.

Tabela 10: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	K –Qera	K- Pasuri të Patundshme dhe Shërbime Profesionale
Berat	1,93	1,82
Dibër	1,58	2,06
Durrës	13,58	6,41
Elbasan	5,57	3,04
Fier	7,11	7,17
Gjirokastrë	1,71	2,77
Korçë	4,39	2,38
Kukës	1,03	1,78
Lezhë	3,16	2,25
Shkodër	5,08	5,27
Tiranë	47,54	60,88
Vlorë	7,32	4,17
Totali	100,00	100,00

3.2.10. NVE L, M ,N – Administrata Publike dhe Mbrojtja Kombëtare; Arsimi; Shëndetsia dhe veprimtari të tjera sociale

Metoda e koston është përdorur në degën e Administratës Publike ku treguesit e VSHB-së janë rishpërndarë duke përdorur treguesit e kompensimit të punonjësve sipas qarqeve.

NVE L – Administrata Publike dhe Mbrojtja Kombëtare.

Kjo degë përfshin njësitë vendimarrëse të Administratës Publike. Këto aktivitete janë të mbuluara nga njësi buxhetore qendrore dhe lokale. Gjithasthu përfshijnë aktivitete të mbrojtjes kombëtare dhe rendi publik, mbrojtja sociale, aktivitete të gjykatave, mbrojtja nga zjarri, etj. Kjo degë është e përbërë nga një degë:

- 75 Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar

Pjesa më e konsiderueshme e prodhimit të degës 75 është “ prodhim produktesh të tjera jo-të tregut”, e llogaritur me metodën koston, duke marrë në konsideratë natyrën që ka aktiviteti i Administratës Publike në prodhimin e produkteve jo të tregut. Këto lloj aktiviteteve karakterizohen nga fakti se të ardhurat e realizuara në mënyrë direkte nga popullata nuk mbulojnë 50% të kostove të hasura për një shërbim të caktuar.

Pë rialokimin e treguesve të VSHB-së është përdorur metoda Pseudo Poshtë-Lart duke përdorur si bazë strukturën e kompensimit të punonjësve. Kompensimi i punonjësve është një indikator i afërt me VSHB-në.

Aktiviteti ekonomik NVE L përbën 3,92 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Vlerësimet sipas qarqeve variojnë nga 2,36% në qarkun Berat dhe 56,38 % në qarkun Tiranë.

NVE M – Arsimi

Aktiviteti ekonomik për degën NVE M përfshin aktivitetin arsimor privat dhe publik, për nivele nga më të ndryshme arsimore, aktivitete arsimore për të rritur (Kurse Patentash,etj). Aktiviteti ekonomik për degën NVE M përbëhet vetëm nga një degë ekonomike:

- 80 Arsimi

Pjesa më e madhe e aktivitetit të arsimit ofrohet nga sektori publik. Për rialokimin e treguesve të VSHB-së është përdorur metoda Pseudo Poshtë-Lart duke përdorur si bazë strukturën e kompensimit të punonjësve.

Aktiviteti ekonomik NVE M përbën 4,26 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Vlerësimet më të konsiderueshme janë në qarqet Tiranë me 28,43 % dhe Elbasan me 11,02%.

NVE N – Shëndetsia dhe veprimtari të tjera sociale

Kjo degë përbëhet nga aktivitete të shëndetsisë, aktivitete të veterinarisë dhe aktivitete sociale. Aktiviteti ekonomik për degën NVE N përbëhet vetëm nga një degë ekonomike:

- 85 Shëndetsia dhe veprimtari të tjera sociale

Për rialokimin e treguesve të VSHB-së është përdorur metoda Pseudo Poshtë-Lart duke përdorur si bazë strukturën e kompensimit të punonjësve.

Aktiviteti ekonomik NVE N përbën 2,93 % të VSHB-së totale për vitin 2012. Vlerësimet më të konsiderueshme janë në qarqet Tiranë me 32,2 % dhe Elbasan me 9,53%.

Tabela 11: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	L- Administrata publike dhe mbrojtja	M- Edukimi	N- Shëndetësia
Berat	2,36	5,05	5,30
Dibër	2,61	4,88	5,23
Durrës	7,04	7,09	2,80
Elbasan	4,42	11,02	9,53
Fier	4,67	9,13	7,00
Gjirokastrë	2,71	3,95	4,44
Korçë	4,95	7,84	8,18
Kukës	2,51	3,55	4,08
Lezhë	3,04	4,51	4,70
Shkodër	4,09	8,23	8,74
Tiranë	56,38	28,43	32,20
Vlorë	5,22	6,32	7,80
Totali	100,00	100,00	100,00

3.2.11. NVE O, P – Aktivitete të tjera të Shërbimit Kolektiv, Social dhe Individual

Aktivitetet ekonomike që bëjnë pjesë në Aktivitete të tjera të Shërbimit Kolektiv, Social dhe Individual janë katër degë:

- 90 Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme
- 91 Aktivitete të organizatave të ndryshme shoqërore
- 92 Aktivitete dëfrimi, kulturore dhe sportive
- 93 Aktivitete të shërbimeve personale
- 95 Shërbime personale

Duke pasur në konsideratë natyrën e aktivitetit ekonomik të kësaj dege, kuptohet se shërbimet e ofruara janë të destinuara për popullatën e gjërë. Në këtë degë mund të përmenden shumica e institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të popullatës si dhe organizatave qeveritare.

Pjesa më e madhe e VSHB-së së gjeneruar në këtë degë mund të haset nga aktivitetet jo-financiare me qëllim krijimin e fitimit. Kjo ndodh si rezultat i faktit se institucionet jo-fitimprurëse kanë një peshë më të ulët si rezultat natyrës së tyre jo-fitimprurëse.

Në vitin 2012 VSHB-ja e kësaj dege përbënte 3,5% të vlerës totale të VSHB-së totale të ekonomisë.

Tabela 11: Pesha e secilit qark në % (dega e ekonomisë =100) viti 2012

<i>Rajon Statistikor</i>	<i>Aktivite të Tjera të Sherbimit Kolektiv, Social dhe Individual</i>
Berat	2,86
Dibër	2,08
Durrës	14,37
Elbasan	6,98
Fier	5,42
Gjirokastrë	1,46
Korçë	5,42
Kukës	0,34
Lezhë	1,42
Shkodër	4,89
Tiranë	50,20
Vlorë	4,56
Totali	100,00

3.3. VSHB RAJONALE ME ÇMIMET E VITIT TË KALUAR

Për vlerësimin e treguesve të PBB-së, nga PBB me çmime korente në PBB me çmime të vitit të kaluar, janë kryer vlerësime të detajuara sipas qarqeve dhe sipas degëve ekonomike specifike. Ky kalim është kryer duke pasur në konsideratë strukturën specifike të disa degë në qarqe të veçanta.

Për vlerësimin e treguesve më çmime të vitit të kaluar janë përdorur indekset e çmimeve përkatëse në nivel kombëtar sipas aktiviteteve ekonomike. Nuk janë përdorur indekse çmimesh në nivel rajonesh për vlerësimin e këtyre treguesve. Treguesit e PBB-së me çmime të vitit të kaluar janë vlerësuar duke ndjekur të njëjtën metodologji të Llogarive Kombëtare Vjetore. Për rajonalizimin e treguesve me çmime të vitit të kaluar janë përdorur metodat rajonalizuese të përmendura gjërësisht edhe më lart.

4. Vetëvlerësim i Llogarive Rajonale dhe plane të ardhshme

Para një vlerësimi të situatës aktuale rreth Llogarive Rajonale në Shqipëri, me theksin në metodologjinë e përdorur për vlerësimin e VSHB-së rajonale, është e rëndësishme të përmendim faktin se Llogaritë Rajonale janë të mbështetura mbi treguesit e Llogarive Kombëtare Vjetore. Rregulli bazë është që totali i treguesve sipas Rajoneve të jetë i barabartë me Treguesit e Llogarive Kombëtare në nivel vendi.

4.1 Vlerësimi i metodologjisë së Llogarive rajonale

Baza metodologjike e Llogarive Rajonale është në linjë me manualin ESA (Sistemi European i Llogarive) kapitulli XIII si dhe Manuali rreth Metodologjisë së Llogarive Rajonale. Mbetet ende punë në proces përmirësimi i metodologjive për arritjen e standarteve të BE-së.

Lidhja me treguesit e Llogarive Kombëtare Vjetore

Totali i vlerësimeve të VSHB-së sipas Rajoneve për degët e ekonomisë, të grupuara sipas qarqeve, është e barabartë me vlerësimet sipas degëve të Llogarive Kombëtare vjetore në nivel vendi.

Nomenklaturat e përdorura

INSTAT kryen vlerësimin e tregueve të Llogarive Kombëtare Vjetore, Tremujore si dhe Rajonale duke përdorur Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike Rev.1.1 (NVE Rev 1.1).

Situata Aktuale

Cilësia e treguesve të Llogarive Rajonale varet nga kontrollet cilësore që kryhen ndaj çelësve rajonalë të përdorur. Një përmirësim i rëndësishëm në llogaritjet rajonale ka arritur si rezultat i adaptimit gjithmonë e më shumë të metodave Posht-Lart dhe metodave Pseudo-Poshtë-Lart, metoda këto që kanë zëvendësuar metodat e vjetra të vlerësimeve Lart-Poshtë. Gjithastu niveli i detajimit të informacioneve me të cilat punohet është zgjeruar duke përfshirë informacione shtesë mbi degët e ekonomisë.

Burimet e informacionit të disponueshme sipas rajoneve statistikore në nivel 2/3 kanë nivele të ndryshme cilësie. Rajonalizimi i treguesve të kompensimit të punonjësve, numri i të punësuarve sipas njësive lokale janë në një nivel të mirë cilësie si tregues.

Gjithashtu metodat Poshtë-Lart mund të përdoren si një formë për kontrollin e cilësor të treguesve ekzistues.

Politikat Revizionuese

Treguesit janë rishikuar si pasojë e ndryshimeve në burimet e të dhënave dhe në metodologjitë e vlerësimit të ndjekura. Një faktor shtesë që ka ndikuar në revizionimet e Llogarive Kombëtare ka qënë procesi i revizionimeve madhore i ndërmarë nga Llogaritë Kombëtare Vjetore. Rishikime të vogla metodologjike janë pjesë përbërëse e revizionimeve të rregullta metodologjike që ndiqen nga Llogaritë Kombëtare.

4.2 Përmirësime të mëtejshme


Përmirësime në burimet e të dhënave dhe metodologjinë

Përdorimi i informacioneve të mbledhura nga një modul special i ndërtuar në Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) , me seksione që mbulojnë tregues rajonalë si Numri i të Punësuarve, Kompensimi i Punonjësve dhe Investimet për njësitë që kryejnë një aktivitet në disa rajone të ndryshme. Të dhënat mblidhen në nivel ndërmarrje me disa informacione rreth njësive lokale.

Çdo biznes ativ ka për detyrim ligjor që të rregjistrohet pranë autoriteteve përkatëse dhe të paiset me një NIPT. Rregjistri i Bizneseve (RB) i grumbullon këto informacione duke dhënë edhe informacione shtesë rreth njësive lokale që janë aktive dhe njësive lokale sipas llojit të aktivitetit ekonomik. RB ka edhe informacione shtesë rreth treguesve të punësimit sipas njësive lokale. Në hapat e ardhshëm do të kryhet një analizë e ndërthurur midis burimeve të informacionit nga ASN dhe RB që disponohen për njësitë lokale.

ANEKS

ANEKS I. – Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011



Kodet e komunave dhe bashkive

1	BERAT	76	NIKËL	181	GRABIAN	226	VITHKUQ	301	RRAPË
2	KUTALLI	77	BELSH	182	GRADISHTË	227	VOSKOP	302	ANA E MALIT
3	LUMAS	78	BRADASHESH	183	HYSGJOKAJ	228	VOSKOPOJË	303	BËRDICË
4	VELABISHT	79	CËRRIK	184	KARBUNARË	229	VRESHTAS	304	BUSHAT
5	OTLLAK	80	ELBASAN	185	KOLONJË	230	BUÇIMAS	305	DAJÇ
6	POSHNJË	81	FIERZE	186	KRUTJË	231	ÇËRRAVE	306	GURI I ZI
7	ROSHNIK	82	FUNARË	187	LUSHNJË	232	DARDHAS	307	HAJMEL
8	SINJË	83	GJERGJAN	188	RREMAS	233	POGRADEÇ	308	VAU I DEJËS
9	TERPAN	84	GJINAR	189	TERBUF	234	PROPTISHT	309	POSTRIBË
10	URA VAJGJURORË	85	GOSTIMË	190	ARANITAS	235	TREBINJË	310	PULT
11	VERTOP	86	GRACEN	191	BALLSH	236	HUENISHT	311	RRETHINAT
12	CUKALAT	87	GREKAN	192	FRATAR	237	VELÇAN	312	SHALE
13	KOZARË	88	KAJAN	193	GRESHICË	238	FAJZA	313	SHKODËR
14	KUÇOVË	89	KLOS	194	HEKAL	239	GOLAJ	314	SHLLAK
15	PERONDI	90	LABINOT FUSHË	195	KUTË	240	GJINAJ	315	SHOSH
16	BOGOVË	91	LABINOT MAL	196	NGRAÇAN	241	KRUMË	316	VELIPOJË
17	ÇEPAN	92	MOLLAS	197	QENDËR	242	ARRËN	317	VIG-MNELË
18	ÇOROVODË	93	PAPËR	198	SELITË	243	BICAJ	318	TEMAL
19	GJERBËS	94	RRASË	199	ANTIGONË	244	BUSHTRICË	319	GOLEM
20	LESHNJË	95	SHALËS	200	CEPO	245	KOLSH	320	GOSË
21	POLICAN	96	SHIRGJAN	201	DROPULL I POSHTËM	246	KUKËS	321	HELMËS
22	POTOM	97	SHUSHICË	202	DROPULL I SIPËRM	247	MALZI	322	KAVAJË
23	QENDËR	98	TREGAN	203	GJIROKASTER	248	ZAPOD	323	KRYEVIDH
24	VENDRESHË	99	ZAVALIN	204	LAZARAT	249	SHISHTAVEÇ	324	LEKAJ
25	ZHEPË	100	GRAMSH	205	LIBOHOVË	250	SHTIQEN	325	LUZ I VOGEL
26	BULOIZË	101	KODOVJAT	206	LUNXHERI	251	SURROJ	326	RROGOZHINË
27	FUSHË BULQIZË	102	KUSHOVË	207	ODRIË	252	TËRTHORË	327	SINABALLAJ
28	GJORICË	103	LENIE	208	PICAR	253	TOPOJAN	328	SYNEJ
29	TREBISHT	104	PISHAJ	209	POGON	254	UJËMISHT	329	BALDUSHK
30	OSTRËN	105	POROÇAN	210	QENDËR LIBOHOVË	255	GRYKË ÇAJË	330	BËRXULLË
31	SHUPENZË	106	SKËNDERBEGAS	211	ZAGORI	256	KALIS	331	BËRZHITË
32	ZERQAN	107	KUKUR	212	BALLABAN	257	BAJRAM CURRI	332	DAJT
33	MARTANESH	108	SULT	213	ÇARÇOVË	258	BUJAN	333	KAMËZ
34	ARRAS	109	TUNJË	214	FRASHËR	259	BYTYÇ	334	KASHAR
35	FUSHË-ÇIDHËN	110	HOTOLISHT	215	KËLCYRË	260	FIERZE	335	NORÇO
36	KALA E DODËS	111	LIBRAZHD	216	PERMET	261	LEKSBIAJ	336	PASKUQAN
37	KASTRIOT	112	LUNIK	217	QENDËR	262	LLUGAJ	337	PETRELË
38	LURË	113	ORENJË	218	SUKË	263	MARGEGAJ	338	PEZË
39	MAQELLARË	114	PËRRENJAS	219	DISHNICË	264	TROPOJË	339	PREZË
40	MELAN	115	POLIS	220	PETRAN	265	FUSHË KUÇE	340	FARKË
41	FUSHË MUHUR	116	QENDËR	221	BUZ	266	LAÇ	341	SHËNGJERGJ
42	PESHKOPI	117	QUKËS	222	FSHAT MEMALIAJ	267	MAMURRAS	342	TIRANË
43	QENDER TOMIN	118	STËBLEVE	223	KRAHËS	268	MILOT	343	VAGARR
44	SELISHTË	119	STRAVAJ	224	KURVELESH	269	BALLDREN I RI	344	VORË
45	SILOVË	120	RRAJCË	225	LOPËS	270	BLINISHT	345	ZALL BASTAR
46	ZALL DARDHË	121	GJOÇAJ	226	LUFTINJË	271	DAJÇ	346	ZALL HERR
47	ZALL REÇ	122	KARINË	227	MEMALIAJ	272	KALLMET	347	KËRRABË
48	LUZIN	123	PAJOVË	228	QENDËR	273	KOLÇ	348	DELVINË
49	BAZ	124	PEQIN	229	QESARAT	274	LEZHË	349	FINIQ
50	DERJAN	125	PËRPARIM	230	TEPELENË	275	SHËNGJIN	350	MESOPOTAM
51	GURRË	126	SHEZË	231	BILISHT	276	SHËNKOLL	351	VERGO
52	KLOS	127	ÇAKRAN	232	QENDËR BILISHT	277	UNGREJ	352	DHIVER
53	KOMSI	128	DERMENAS	233	MIRAS	278	ZEJMEN	353	KONISPOL
54	LIG	129	FIER	234	HOÇISHT	279	FAN	354	LIVADHJA
55	MACUKULL	130	FRAKULL	235	PROGER	280	KAÇINAR	355	LUKOVË
56	BURREL	131	RUZHDIE	236	BARMASH	281	KTHJELLE	356	SARANDE
57	RUKAJ	132	KUMAN	237	ÇLIRIM	282	OROSH	357	XARRË
58	SUÇ	133	KURJAN	238	ERSEKË	283	RRESHEN	358	ALIKO
59	ULËZ	134	LEVAN	239	LESKOVIK	284	RUBIK	359	MARKAT
60	XIBËR	135	LIBOFSHË	240	LESKOVIK	285	SELITË	360	KSAMIL
61	DURRËS	136	MBROSTAR	241	MOLLAS	286	GRUËMIRË	361	BRATAJ
62	GJEPALAJ	137	PATOS	242	NOVOSELË	287	KASTRAT	362	HIMARË
63	ISHËM	138	PORTEZ	243	QENDËR	288	KELMEND	363	KOTE
64	KATUND I RI	139	QENDËR	244	DRENOVË	289	KOPLIK	364	NOVOSELË
65	MAMINAS	140	ROSKOVEÇ	245	GORË	290	QENDËR	365	ORIKUM
66	MANEZ	141	STRUM	246	KORÇË	291	SHKREL	366	QENDËR
67	RRASHBULL	142	TOPOJË	247	LEKAS	292	BLERIM	367	SELENICË
68	SHUAK	143	ZHARRËS	248	LIBONIK	293	FIERZË	368	SEVASTER
69	SUKTH	144	ALLKAJ	249	LIQENAS	294	FUSHË ARRËZ	369	SHUSHICË
70	XHAFZOTAJ	145	BALLAGAT	250	MALIQ	295	GJEGJAN	370	VLLAHINË
71	BUBQ	146	BUBULLIMË	251	MOGLICË	296	IBALLË	371	VLORË
72	CUDHI	147	DIVJAKË	252	MOLLAJ	297	PUKË	372	VRAINISHT
73	FUSHË KRUIË	148	DUSHK	253	PIRQ	298	QELEZ	373	ARMEN
74	KODËR THUMANË	149	FIERSHEGAN	254	POJAN	299	QERRËT		
75	KRUJË	150	GOLEM	255	QENDËR	300	QAFË MALI		

ANEKS II. Tabela e Llogaritjes së VSHB-së Rajonale

Tabela e Llogaritjes së VSHB-së Rajonale

Viti 2012

në milion lekë

Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve (Klasifikimi në nivel NUTS 3)															
	Metodat për periudhën referuese t														
	Metodat Poshtë-Lart							Totali i metodës Poshtë-Lart	Metodat Lart-Poshtë				Totali i metodës Lart-Poshtë	Rregullimet (adjustments)	Totali
	Të dhëna nga anketat				Të dhëna administrative		Të dhëna të bazuara në ekstrapolime dhe modele		Të dhëna nga anketat dhe regjistrimet		Të dhëna administrative				
	Mbulimi gjithëpërfshirës		Të dhëna nga kampioni		Uni-rajonale	Multi-rajonale			Indikatorë të përafërt me VSHB-në	Të dhëna të bazuara në ekstrapolime dhe modele					
	Uni-rajonale	Multi-rajonale	Uni-rajonale	Multi-rajonale			Uni-rajonale	Multi-rajonale							
Degët e Industrisë A 25	2	3	4	5	6	7	8	9 (=2+3+4+5+6+7+8)	10	11	12	13	14 (=10+11+12+13)	15 = [16-(9+14)]	16
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura			0	0				0	250.767				250.767		250.767
2 Peshkimi			0	0				0	1.843				1.843		1.843
3 Industria nxjerrëse e produkteve energjetike			1.276	48.144				49.420	692				692		50.112
4 Industria nxjerrëse e produkteve jo-energjetike			4.432	5.709				10.141	4.929				4.929		15.070
5 Industria e produkteve ushqimore me bazë drithërat			2.209	694				2.903	1.237				1.237		4.140
6 Industria e produkteve të tjera ushqimore			3.230	3.026				6.256	2.516				2.516		8.772
7 Industria e tekstile, e veshjes dhe e lëkurës			11.717	2.992				14.709	4.471				4.471		19.179
8 Industria e përpunimit të drurit, artikujve prej druri, mobiljeve, letrës			7.091	1.783				8.874	5.990				5.990		14.864
9 Produkte të koksifikimit, rafinimit dhe industrisë nukleare			-791	3.623				2.832	-179				-179		2.653
10 Industria kimike, kauçukut dhe plastikës.			1.982	613				2.595	1.059				1.059		3.654
11 Industria e produkteve minerale jo-metalike			5.895	2.316				8.211	3.159				3.159		11.369
12 Industria e metaleve bazë dhe fabrikimi i produkteve prej metali			3.250	6.575				9.825	2.314				2.314		12.139
13 Industria e makineri pajisjeve			1.120	37				1.157	477				477		1.635
14 Energji elektrike			0	9.580				9.580	9.580				9.580		19.161
14/1 Gaz, ujë dhe avull			2.072	2.506				4.578	-371				-371		4.207
15 Ndërtimi			40.987	18.354				59.341	81.310				81.310		140.651
16 Tregtia me shumice dhe pakice			63.382	36.229				99.610	51.820				51.820		151.430
17 Hotele dhe restorante			15.099	998				16.096	7.657				7.657		23.754
18 Transporti			16.277	14.140				30.418	13.569				13.569		43.987
19 Posta dhe komunikacioni			3.929	21.396				25.326	9.367				9.367		34.693
20 Ndërmjetësimi monetar dhe financiar			0	0				0	32.133				32.133		32.133
21 Renta			0	0				0	73.947				73.947		73.947
21 Pasuritë e patundshme, dhëna me qera, aktivitete profesionale			27.631	9.571				37.202	16.106				16.106		53.308
22 Administrata publike dhe mbrojtja			0			52.360		52.360	0				0		52.360
23 Edukimi			0			44.684		44.684	12.159				12.159		56.844
24 Shëndetësia			0			24.933		24.933	8.954				8.954		33.887
25 Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual			21.305	9.570				30.875	9.944				9.944		40.819
A në P	-	-	232.094	197.856	0	121.977	0	551.928	605.449	0	0	0	605.449	0	1.157.377

ANEKS III. Struktura e degëve të ekonomisë në % viti 2012

Kodi Aktfr	VSHB sipas degëve in Milion lek	Struktura e VSHB ndaj totalit të vendit %
1	250.767	21,7
2	1.843	0,2
3	50.112	4,3
4	15.070	1,3
5	4.140	0,4
6	8.772	0,8
7	19.179	1,7
8	14.864	1,3
9	2.653	0,2
10	3.654	0,3
11	11.369	1,0
12	12.139	1,0
13	1.635	0,1
14	19.161	1,7
15	4.207	0,4
16	140.651	12,2
17	151.430	13,1
18	23.754	2,1
19	43.987	3,8
20	34.693	3,0
21	32.133	2,8
22	73.947	6,4
22/1	53.308	4,6
23	52.360	4,5
24	56.844	4,9
25	33.887	2,9
26	40.819	3,5
TOTAL	1.157.377	100,0

ANEKS IV. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike

Kodi		Dega	
NVE Rev.1.1			
A	1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura
B	2	Peshkimi	Peshkimi
C	3	Industria Nxjerrëse	Industria nxjerrëse e produkteve energjetike
	4		Industria nxjerrëse e produkteve jo-energjetike
D	5	Industria përpunuese	Industria e produkteve ushqimore me bazë drithërat
	6		Industria e produkteve të tjera ushqimore
	7		Industria e tekstile, e veshjes dhe e lëkurës
	8		Industria e përpunimit të drurit, artikujve prej druri, mobiljeve, letrës, shtypshkrime dhe botime
	9		Produkte të koksifikimit, rafinimit dhe industrisë nukleare
	10		Industria kimike, kauçukut dhe plastikës.
	11		Industria e produkteve minerale jo-metalike
	12		Industria e metaleve bazë dhe fabrikimi i produkteve prej metali
	13		Industria e makineri pajisjeve
E	14	Energji elektrike, gaz, ujë dhe avull	Energji elektrike, gaz, ujë dhe avull
F	15	Ndërtimi	Ndërtimi
G	16	Tregtia me shumice dhe pakice, Riparimi i automobilitave, motoçikletave dhe paisjeve shtëpiake	Tregtia
H	17	Hotele dhe restorante	Hotele dhe restorante
I	18	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	Transporti
	19		Posta dhe komunikacioni
J	20	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar
K	21	Pasuritë e patundshme, dhënia me qera, aktivitete profesionale	Pasuritë e patundshme, dhënia me qera, aktivitete profesionale
L	22	Administrata publike dhe mbrojtja	Administrata publike dhe mbrojtja
M	23	Edukimi	Edukimi
N	24	Shëndetësia dhe veprimtari sociale	Shëndetësia
O	25	Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv , social dhe individual	Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv , social dhe individual

ANEKS V. Referenca

EUROSTAT: *Manual i Llogarive Rajonale, 2013*

http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-GQ-13-001/EN/KS-GQ-13-001-EN.PDF

KOMISIONI EVROPIAN. *Sistemi i Llogarive Kombëtare Evropiane ESA 2010.* EUROSTAT, 2013

BULETINI ZYRTAR I BASHKIMIT EVROPIAN: *RREGULLORE (KE) Nr 1059/2003- mbi vendosjen e klasifikimit të njësisve territoriale për statistikat (NUTS), of 26 Maj 2003*